

VENDIM
Nr. 793, datë 28.12.2023

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 325, DATË 31.5.2023, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS SË PAGAVE, NIVELEVE TË PAGAVE DHE SHTESAVE TË TJERA MBI PAGË TË ZËVENDËSMINISTRIT, FUNKSIONARËVE TË KABINETEVE, PREFEKTIT, NËNPREFEKTIT, NËPUNËSVE CIVILË DHE NËPUNËSVE NË DISA INSTITUCIONE TË ADMINISTRATËS PUBLIKE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të shkronjës “a”, të pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr. 35/2023, “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”; të shkronjës “h”, të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, dhe të neneve 7 e 9, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, strukturat dhe shpërblimet e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 325, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Në pikën 1, të kreut I, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Në shkronjën “c”:

i. Emërtesa “Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave” zëvendësohet me “Agjencia e Inteligjencës Financiare”;

ii. Pas emërimit “Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve” shtohet “Agjencia e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyera”;

iii. Pas emërimit “Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve” shtohet “Agjencia Kombëtare e Kontrollit të *Cannabis-it*”.

b) Në shkronjën “ç”, pas emërimit “Agjencia Shtetërore për Shpronësim” shtohet “Qendra Rajonale e Inovacionit të Institutit Evropian të Teknologjisë dhe Inovacionit për Lëndët e Para (*EIT Raw Materials Regional Innovation Centre*)”.

2. Në kreun III bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Në pikën 8/2, fjalët “Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave” zëvendësohen me “Agjencinë e Inteligjencës Financiare”;

b) Pas pikës 8/5 shtohet pika 8/6, me këtë përmbajtje:

“8/6. Klasat e pagave dhe shtesat për kushte pune (natyrë të veçantë pune) për pozicionet e punës së nëpunësve në Agjencinë Kombëtare të Kontrollit të *Cannabis-it* janë sipas lidhjes nr. 9/6, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.

c) Pas pikës 9/10 shtohet pika 9/11, me këtë përmbajtje:

“9/11. Klasat e pagave dhe shtesat për kushte pune (natyrë të veçantë pune) të pozicioneve të punës së nëpunësve në Qendrën Rajonale të Inovacionit të Institutit Evropian të Teknologjisë dhe Inovacionit për Lëndët e Para (*EIT Raw Materials Regional Innovation Centre*) janë sipas lidhjes nr. 10/11, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.

3. Në lidhjen nr. 9, pas fjalëve “specialist në njësitë organizative të përmbajtjes në Agjencinë Telegrafike Shqiptare” shtohen “specialist në njësitë organizative të përmbajtjes në Agjencinë e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyera.”.

4. Në titullin e lidhjes nr. 9/2, fjalët “Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave” zëvendësohen me “Agjencinë e Inteligjencës Financiare”.

5. Në lidhjen nr. 12, pas fjalëve “përgjegjës sektori në zyrat vendore të arsimit parauniversitar” shtohen “specialist në zyrat rajonale të Avokatit të Popullit”.

II. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, fillojnë nga data e emërimit të nëpunësit në detyrë dhe për vitin 2023 përballohen nga fondet e miratuara për secilin institucion për këtë vit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Lidhja nr. 9/6

Klasat e pagave dhe shtesat për kushte pune (natyrë të veçantë pune) për pozicionet e punës së nëpunësve në Agjencinë Kombëtare të Kontrollit të Cannabis-it

Pozicioni	Klasa e pagës	Grupi i diplomës	Shtesa për kushte pune (natyrë të veçantë pune) (lek/muaj)
Titullar i institucionit	I-3	1	20 000
Drejtor i drejtorive të përmbajtjes; Koordinator.	II-1	1	15 000
Drejtor i drejtorive mbështetëse.	II-2	1	0
Përgjegjës i sektorëve të përmbajtjes.	III-1	1	14 000
Përgjegjës i sektorëve mbështetës.	III-2	1	0
Specialist në sektorët apo drejtoritë e përmbajtjes.	IV-1	1 ose 2	14 000
Specialist në sektorët apo drejtoritë mbështetëse.	IV-2	1 ose 2 ose 3	0
	IV-3		0

Lidhja nr. 10/11

Klasat e pagave dhe shtesat për kushte pune (natyrë të veçantë pune) të pozicioneve të punës së nëpunësve në Qendrën Rajonale të Inovacionit të Institutit Evropian të Teknologjisë dhe Inovacionit për Lëndët e Para (EIT Raw Materials Regional Innovation Centre)

Pozicioni	Klasa e pagës	Grupi i diplomës	Shtesa për kushte pune (natyrë të veçantë pune) (lek/muaj)
Titullar i institucionit	I-4	1	70 000
Ekspertë	II-1	1	50 000